



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DIMAL**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Procesverbal**  
**Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Dimal**  
**Mbajtur më date 31.08.2023**

Ora e hapjes së mbledhjes 14:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes në Njësinë Administrative Poshnje kati i I-rë salla e mbledhjeve e Këshillit të Bashkisë Dimal. Mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Dimal e hapur.

Listë prezenca e këshilltarëve pjesmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.

1. Anila Shahini
2. Adelina Vangjeli
3. Avdulla Salillari
4. Bajame Mjelli
5. Bajame Zyka
6. Bujar Dhembo
7. Gerta Kumaraku
8. Gramoz Hazizolli
9. Hysen Hoxha
10. Julian Kora
11. Kozeta Protoduari
12. Lorenc Plaku
13. Luto Goga
14. Petref Sula
15. Petro Tumani
16. Razije Baho
17. Saljon Hoxha
18. Shkelqim Tafa

U deklarua korumi prej 18 Këshilltarësh.

Në mbledhje janë të pranishëm përfaqësues të administratës të cilët kanë hartuar projekt vendimet që do të merren në shqyrtim.

Kryetari i Këshillit deklaroj hapjen e mbledhje.

**Pika 1 e rendit të ditës:** Miratimi i rendit të ditës, i cili deklaroi se rendi i ditës ka një shtesë tek të ndryshmet. Të gjithë anëtarët janë dakort me rendin e ditës.

**Pika 2 e rendit të ditës:** Miratimi i proces verbalit të mbledhjes së kaluar, miratohet.

**Pika 3 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për 5 familje me fond prej 53.757 lekë për muajin Qershor 2023.

D.Lalo: Fillon për të mbrojtur materialin.

G.Hazizolli bën ndërrhyrje kaq familje ishin për të përfituar këtë ndihmë?

D.Lalo: përgjigjet se këto familje kanë aplikuar për ndihmë duke i plotësuar këto kërkesa në lidhje për të përfituar ndihmë.

Kryetarja e Bashkisë: bën një ndërrhyrje për të saqruar situatën në lidhje me përfitimin e ndihmës ekonomike.

R.Hoxha: këto janë kërkesa që aplikohen në sistem dhe dalin emrat përfitues.

Kryetarja e Bashkisë: të përfitojnë familjet të cilat vërtet kanë nevojë për ndihmë ekonomike.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 13 Vota pro dhe 4 vota kundër.

**Pika 4 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt vendimit, trajtimi me ndihmë ekonomike sipas listës emërore bashkëlidhur për 106 familje nga fondet e Bashkisë në shumën 245000 lekë për muajin Korrik 2023.

D.Lalo: Në mbështetje të ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 “ Për ndihmë dhe Shërbime Shoqërore “ i ndryshuar, VKM nr.955 datë 07.12.2016 “ Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe Sektori i Ndhmës Ekonomike propozon trajtimin me ndihmë ekonomike për 106 familje Korrik 2023.

G.Hazizolli: Administrata të bëjë verifikimet për emrat që përfitojnë ndihmë.

G.Kumaraku: Propozon për tu trajtuar me ndihmë ekonomike një familje e cila është në gjendje të vështirë ekonomike Z. Osmën Protoduari.

Kryetarja e Bashkisë: Të aplikojnë dhe të ngrihet një grup për të bërë verifikimet përkatëse.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 18 Vota pro nga 18 Keshilltarë prezentë.

**Pika 5 e rendit të ditës:** Mbi autorizimin e Komisionit Ekonomik, Financ, Buxhet e Tatim Taksa për të shqyrtuar projekt-vendimet që lidhen me dhënien e ndihmave ekonomike nga Buxheti i Shtetit 6% dhe nga fondet e Bashkisë Dimal.

R.Shuka: Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë Dimal ka hasur vështirësi në shpërndarjen në kohë të ndihmave ekonomike nga buxheti i Shtetit, 6% si dhe ndihmat nga fondet e Bashkisë.

Këto vështirësi kanë ardhur nga mospërputhja në kohë të kalimit të ndihmës ekonomike, përlogaritjes së fondit 6% rakordimit të numrit manual dhe elektronik si dhe mundësisë e mbledhjes së Këshillit Bashkiak në kohën e duhur. Këto probleme kanë ndikuar në anomalitë në dhënien e ndihmave për grupet me vështirësi ekonomike. Ngritja e këtij komisioni do të lehtësonte procedurat në kohë.

H.Hoxha: Kërkoj që të ripërcaktoni caktë emërtesën e komisionit ku cilësohet nga fondet e Bashkisë Dimal dhe jam pro ngritjes së këtij komisioni i cili mundëson shpërndarjen e ndihmave në kohë dhe zbutjen e problemeve sociale.

A.Salillari: Hidhet për votim, dhe miratohet me 18 Vota pro nga 18 Këshilltarë prezëntë.

**Pika 6 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e Fondit Ndihmë për familjen e Juela Xhafa në masën 100.000 lekë.

R.Shuka: Po ju paraqesim materialin për dhënien e ndihmës ekonomike në një familje prej 6 antarësh. Bashkëshorti i saj ka pësuar aksident dhe është i paaftë për punë. Banesa ku jeton është në kushte minimale të jetesës dhe fëmijët e rritur nuk kanë asnjë mundësi të shkollohen. Nëpërmjet kësaj ndihme sigurohet pagesa e qerasë mujore në një banesë normale për të jetuar.

G.Hazizolli: Cilat janë kriteret që duhet të përfitoj kjo familje ndihmë?

R.Shuka: Është në kushte minimale për jetesën në gjendje shumë të vështirë ekonomike. Janë trajtuar disa raste nga verifikimet e situatës kanë rezultuar se janë në gjendje të vështirë ekonomike.

A.Salillari : Hidhet në votim, miratohet me 18 Vota pro nga 18 këshilltarë prezëntë.

**Pika 7 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit të përdorimit të fondit ndihmë për familjen në nevojë Znj.Marsela Calameni.

R.Shuka: Familja jeton në gjendje shumë të vështirë ekonomike e divorcuar me 2 fëmijë të mitur të cilët kanë shfaqur probleme të rënda shëndetësore të cilët kërkojnë kura të vazhdueshme.

Situata e saj sociale dhe ekonomike është shumë e vështirë, nuk disponon asnjë banesë në pronësi të saj.

Në të tilla kushte ku pamundësia si dhe pamjftueshmëria e kushteve ekonomike dhe financiare apo kushteve jo të mjaftueshme për jetesë normale kërkon që të ndihmohet për pagesën e qirasë mujore ku të siguroj një banesë normale për të jetuar.

A.Salillari : Hidhet në votim, miratohet me 18 Vota Pro nga 18 Këshilltarë prezëntë.

**Pika 8 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e rishikimit dhe shtesës së buxhetit për vitin 2023.

M.Bizdani: Informacioni i paraqitur pranë jush është në mbështetje tëVKM-së përkatëse për pagat 31.05.2023 nga buxheti i shtetit është akorduar një shumë në masën 8.034.795 lekë i cili do të përdoret për rrijen e pagave të punonjësve mbështetës. Kërkohet nga ana juaj miratimi i fondit sipas destinacionit përkatës me efekt rriten e pagave të këtyre punonjësve që janë paraqitur sipas tabelës bashkëlidhur.

G.Hazizolli: Është fond?

M.Bizdani është fond i pakushtëzuar.

L.Plaku a do ndikojë në rritje pagash për specialistët?

M.Bizdani: Nuk e kemi sjell akoma në këshill, por do ta sjellim patjetër që duhet të aplikojmë rritjen brenda kuadrit ligor dhe nëpërmjet këtij materiali synohet shtesa dhe rishikimi i buxhetit për likuidim përfundimtar të objektit nga gërryerjet e lumit Osum duke pakësuar shpenzimet operative në masën 968.000 lekë.

A.Salillari : Hidhet në votim dhe miratohet me 18 Vota pro nga 18 keshillatrë prezentë.

**Pika 9 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e rinovimit të kontratës së Qirasë lidhur nëpërmjet Bashkisë Dimal dhe Shell.

R.Shuka Është një kontratë e lidhur në 2021 me Shell UPS e cila ka përfunduar në Korrik 2023. Kjo kontratë ka pasur synim kryerjen e punimeve të shpim kërkimit nga kompania Shell dhe vlera e qirasë nga kjo kontratë është 2.663.936 lekë për 2 vite.

G.Hazizolli: Është një investim strategjik pasi jemi njohur me materialin.

B.Dhembo: Më sqaroni më shumë rreth kontratës?

R.Shuka: Në vijim të kontratës me Shell janë përcaktuar modalitetet, për të ardhurat nga Fondi i Bashkisë. Kjo shumë është cdo 2 vite, nëse do të pranohet rinovimi i saj.

B.Dhembo: Kjo është dicka plus dhe është pozitive.

L.Plaku: Pusi që shtohet në Konesbaltë, ky pus është në administrimin e bashkisë Dimal apo në Bashkinë Berat. Duhet të bëhen verifikimet në të për të përcaktuar përfitimin nga masa e rentës që i takon Bashkisë sepse është një e ardhur e konsiderueshme në buxhetin tonë.

A.Salillari:Hidhet në votim dhe miratohet me 18 vota pro nga 18 këshilltarë prezentë.

**Pika 10 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt vendimit në parim të dhëniës me qira të pronës shtetërore pasurisë nr 455/4 në zk 3032.

R. Hoxha: Është një relacion i cili ka ardhur bazuar në kërkesat e qytetarëve, administruar pranë Bashkisë Dimal.

Sh.Tafa: Ku ndodhet kjo pronë?

R.Hoxha: Kjo pronë ndodhet në Njësinë Administrative Poshnje me nr pasurie 455/4 zk 3032 nga të cilat bashkia disponon me certifikatë pronësie pasurinë 455/19 me siperfaqe 165m2. Në të gjitha rastet që vijnë nga kërkesat e qytetarëve, miratimi në këshill është vetëm parimor.

G.Hazizolli: Të na kishit sjellë nje certifikatë pronësie.Në këtë që do jepni mi qera ka ndertime sot, ne duhet ta dimë sa është siperfaqa në certifikatë.

Mund të bëni veifikimet përkatëse, sipas VKM-së mund të jepet deri ne 20 vjet. Por ne kemi percaktuar afatin 5 vjecar.

Sh.Tafa meqënëse kjo pronë është e bashkisë pse nuk bëhet për ndihmë për raste emergjente.

Kryetarja e Bashkisë: Juve mund të na sillni propozimet tuaja ne kemi detyrim t'iu sjellim.

G.Bolani: Ka një certifikatë pronësie.

A.Salillari: Hidhet në votim, nga ku rezultoi se projekt vendimi mori 11 Vota pro dhe 7 vota kundër dhe miratohet.

**Pika 11 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e fillimit të procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë së fshatrave dhe Kryetarit të Fshatit.

A.Salillari: Ky është një projekt vendim që përcakton fillimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë së fshatrave, kryetarit të fshatit dhe këshillave komunitar Nisur nga përvoja e mëparshme e këtyre zgjedhjeve ju kemi paraqitur një listë me emra të mundshëm të këshilltarëve për të ndjekur këtë proces votimi nëpër fshatra.

R.Shuka: afati ligjor për përfundimin e procedurave të zgjedhjeve të kryetarit te fshatit është brenda 3 muajve nga konsituimi të Këshillit Bashkiak.

Jemi në kohë për të filluar dhe përfunduar procedurat brenda këtij afati.

B.Dhëmbo: Nisur nga fakti që nuk janë paraqitur propozimet nga grupet e Këshilltarëve për këto zgjedhje brenda ditës së sotme negocioni emrat përkatës që do të monitoroni për zgjedhjet në mënyrë që procesi zgjedhor të shkoj mirë.

A. Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 18 vota pro nga 18 këshillatrë prezentë.